

## Vendim nr. 130 datë 10.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 10.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** KRISTOFOROS HASA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 137 (80-2022-145), datë 26.01.2022 të Gjykatës së Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 535 (86-2023-781), datë 17.07.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-297, datë 05.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, me tjetër trup gjykues.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## **Rrethanat e çështjes**

1. Me urdhrin nr. 231, datë 21.11.2007 të Prokurorit të Përgjithshëm, shtetasi Kristoforos Hasa (*kërkuesi*) është emëruar në detyrën e oficerit të Policisë Gjyqësore në sektorin e Përgjimit të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme. Në vijim, me urdhrin nr.91, datë 31.03.2008 të Prokurorit të Përgjithshëm kërkuesi është transferuar në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ndërsa me urdhrin nr. 63, datë 21.03.2014 të Prokurorit të Përgjithshëm ai është transferuar në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në vijim, përmes urdhrit nr.184, datë 14.06.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm kërkuesi është shkarkuar nga detyra e oficerit të Policisë Gjyqësore, me motivacionin se kishte kryer shkelje të përsëritura të etikës që diskreditonin figurën dhe pozitën e punonjësit të Policisë Gjyqësore dhe marrëdhëniet financiare i ishin ndërprerë në datën 15.06.2016.

2. Në këto rrethana, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt: (i) shpalljen si absolutisht të pavlefshëm të urdhrin për lirim nga detyra; (2) fshirjen e masës disiplinore në dosjen personale; (3) kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës si oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; (4) rivendosjen e të gjitha të drejtave për statusin dhe pensionin suplementar si oficer i Policisë Gjyqësore nga data 15.06.2016 deri në rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

### *(i) Procesi i parë gjyqësor*

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4627 (80-2016-4647), datë 10.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, me arsyetimin se urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm ishte një akt administrativ i nxjerrë nga një organ i identifikuar brenda kompetencave të tij dhe në formën e procedurës së parashikuar nga ligji. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesi.

4. Pas shqyrtimit gjyqësor të ankimit Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.70, datë 02.02.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr.184, datë 14.04.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe duke përcaktuar detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë kërkuesit 12 paga mujore dëmshpërblim. Për pjesën tjetër të kërkeve të tij gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se në kushtet e mungesës tërësore të zbatimit të procedurës që parashikon shprehimisht dhe hollësisht ligji i

posaçëm për fillimin e procedimit disiplinor, kryerjen e tij dhe dhënien e masës disiplinore, nuk është zbatuar procesi i rregullt ligjor. Po kështu, akti administrativ objekt gjykimi është nxjerrë në kundërshtim me procedurën thelbësore të përcaktuar nga ligji, pra është një akt absolutisht i pavlefshëm. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili është ende në proces shqyrtimi.

*(ii) Procesi i dytë gjyqësor*

5. Kërkuesi në datën 11.05.2021 ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesëpadi me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror në formën e dëmit shëndetësor, integritetit fizik, si dhe cenimit të nderit, personalitetit dhe reputacionit nga veprimet e palës së paditur në shumën 12.571.911 lekë.

6. Pas shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë së kërkuetit Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.137 (80-2022-145), datë 26.01.2022, ka vendosur rrëzimin e saj, si të pambështetur në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.535 (86-2023-781), datë 17.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se ky vendim ishte marrë në zbatim të drejtë të dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe duhej lënë në fuqi. Kundër këtij vendimi, në datën 02.10.2023, kërkuesi ka ushtruar rekurs.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-297, datë 05.02.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit, me arsyetimin se ai haptazi nuk ngrinte asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

9. Në datën 03.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.04.2024.

## II

### **Pretendimet e kërkuetit**

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 10.1. *Parimit të ligjshmërisë dhe të dhënies së drejtësisë*, pasi në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk është vendosur objekti i kërkesëpadisë së kërkuarit, por një objekt tjetër i pakërkuar nga ai, duke shkelur parimin e ligjshmërisë dhe atë të dhënies së drejtësisë. Po kështu, gjykata e shkallës së parë e ka ndryshuar edhe bazën juridike të kërkesëpadisë së kërkuarit pa pëlqimin e tij, duke vendosur si të tillë nenin 625 të Kodit Civil dhe jo dispozitat e Kodit të Punës, ose vendimin unifikues nr. 31, datë 14.04.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr.31/2003*). Në kërkesëpadinë e tij është kërkuar shpërblimi i dëmit jopasuror i shkaktuar nga veprimi i paligjshëm dhe me faj i palës së paditur dhe jo shfuqizimi i ndonjë akti administrativ dhe rikthimi në punë.
- 10.2. *Së drejtës së aksesit në gjykatë në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar kërkuarin për mënyrën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore ose në dhomën e këshillimit për përbërjen e trupit gjykues, ndryshimin e tij, si dhe datën e orën e seancave gjyqësore. Po kështu, gjykata e apelit nuk e ka njoftuar atë as për dërgimin e parashtrimeve, në kushtet kur çështja po shqyrtohej në dhomën e këshillimit në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.
- 10.3. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar kërkuarin për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues. Një nga gjyqtarët e çështjes së caktuar në fillim, në përbërjen e trupit gjykues, ka dhënë dorëheqjen, por ky fakt nuk i është njoftuar kërkuarit, duke i mohuar këtij të fundit të drejtën për t'u njohur me përbërjen e re të trupit gjykues, të drejtën për të kërkuar përjashtimin ose jo të ndonjërit prej gjyqtarëve, ose të të gjithë trupit gjykues, fakt i cili cenon parimin e procesit të rregullt ligjor. Edhe pse ky pretendim është ngritur në rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim.
- 10.4. *Parimit të gjësë së gjykuar*, pasi gjykatat e faktit kanë arsyetuar se çështja në gjykim është *res judicata*, arsyetim ky që bie në kundërshtim me këtë parim, pasi në rastin konkret objekti i padisë është kërkimi i dëmit jopasuror nga organi publik që ka cenuar të drejtat dhe interesat e kërkuarit me një akt administrativ, konstatuar kjo me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo padia me objekt kërkimi pavlefshmërinë e aktit administrativ me anë të të cilit kërkuesi është shkarkuar nga detyra dhe kërkon rikthimin e tij në punë.

10.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, i paqartë dhe jo i plotë. Ky kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos u dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të tij, ndonëse shkaqet e ngritura në të janë të argumentuara dhe të mbështetura ligjërisht. Po kështu, Kolegji Administrativ nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për shkeljet kushtetuese të gjykatës së apelit, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, e duke mos dhënë arsye për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke

respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të ligjshmërisë dhe të dhënies së drejtësisë, me argumentin se në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk ishte vendosur objekti i kërkesëpadsisë së tij, por një objekt tjetër i pakërkuar nga ai, si dhe ishte ndryshuar baza ligjore e padsisë pa pëlqimin e tij; cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar kërkuenin për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues, në kushtet kur një nga gjyqtarët e çështjes së caktuar në fillim, në përbërjen e trupit gjykues, ka dhënë dorëheqjen. Lidhur me këto pretendime, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur ato në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë vlerëson se ai nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë, në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar, parimit të gjësë së gjykuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vëren se ato në thelb janë ngritur në rekurs ose drejtohen ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur gjykimin e çështjes. Ndaj, në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

16. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin objekt shqyrtimi konstatohet se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 05.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 03.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Si rrjedhim, Kolegji çmon se ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar, parimit të gjësë së gjykuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

18. Nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual Kolegji konstaton se pretendimi i tij për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, në thelb, ka të bëjë me kundërshtimin që ai i bën arsytimit të gjykatave të faktit, të cilat e kanë rrëzuar padinë e tij, duke i cilësuar kërkimet e tij *res judicata*, për sa kohë që në procesin e parë gjyqësor ato i kanë akorduar atij dëmshpërblim për largimin e padrejtë nga puna. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimi i mësipërm do të analizohet në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar*

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar atë lidhur me mënyrën e shqyrtimit të çështjes në seancën gjyqësore ose në dhomën e këshillimit për përbërjen e trupit gjykues, ndryshimin e tij, si dhe datën e orën e seancave gjyqësore. Po kështu, gjykata e apelit nuk e ka njoftuar as për dërgimin e parashtrimeve, në kushtet kur çështja po shqyrtohej në dhomën e këshillimit në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Kështu, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në aspektin procedural, shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe rregullat e njoftimit janë të përcaktuara në nenin 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit, sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara, kurse palët kanë të drejtë të paraqesin deri në 5 ditë përpara seancës parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit. Ndërkohë, rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, pikërisht neni 482, paragrafi i tretë, i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), parashikon detyrimin e sekretarisë për shpalljen e listave të shqyrtimit të rekurseve të paktën

15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

22. Në bazë të akteve të administruara në dosjen gjyqësore të tërhequr për efekt të këtij shqyrtimi, Kolegji vëren se kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkuesi, i përfaqësuar me avokat të zgjedhur vetë, ka paraqitur ankim në datën 21.02.2022. Në vijim, përmes vendimit të datës 09.03.2022, relatori i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes administrative në dhomën e këshillimit në datën 22.02.2023. Në datën 07.02.2023 gjykata e apelit ka publikuar shpalljen për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 22.02.2023, ku, ndër të tjera, pasqyrohen edhe anëtarët e trupit gjykues, relatori i çështjes, data dhe ora e zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, si dhe njoftimi që palët kanë të drejtë të dorëzojnë parashtrime me shkrim deri në 5 (ditë) përpara datës së shqyrtimit të çështjes në sekretarinë e kësaj gjykate. Në kushtet e shtyrjes së datës për shqyrtimin e çështjes, Gjykata e Administrative e Apelit ka publikuar në faqen e saj zyrtare, si dhe ka afishuar në mjediset e jashtme të saj edhe shpalljet e datave 06.04.2023, 11.05.2023, 17.05.2023, 21.06.2023 dhe 06.07.2023 përmes të cilave njoftohej gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit në datat 11.05.2023, 17.05.2023, 25.05.2023, 06.07.2023 dhe 17.07.2023. Në këto shpallje rezultojnë sërish të pasqyruara edhe të dhënat për trupin gjykues, datat dhe oraret e gjykimit të çështjes.

23. Për sa më lart, në kundërshtim me sa pretendohet nga kërkuesi, Kolegji konstaton se ai ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit të tij në dhomën e këshillimit, pasi përfaqësuesi i tij ligjor ka depozituar në gjykatën e apelit parashtrimet me shkrim të datës 16.02.2023. Në këto parashtrime, përfaqësuesi ligjor i kërkuesit shprehet se nga sekretaria e Gjykatës Administrative të Apelit i është bërë e ditur se është caktuar data e gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit në datën 22.02.2023, ora 13:30.

24. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka cenuar ligjin procedural për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve me shpallje.

25. Si rrjedhim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*



26. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar se çështja në gjykim ishte çështje e gjykuar më parë, pra *res judicata*. Ky arsyetim bie në kundërshtim me këtë parim, pasi, në rastin konkret, objekti i padisë ishte kërkimi i dëmit jopasuror nga organi publik që kishte cenuar të drejtat dhe interesat e kërkuesit me një akt administrativ, konstatuar kjo me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo padia me objekt kërkimi për pavlefshmërinë e aktit administrativ me anë të të cilit kërkuesi ishte shkarkuar nga detyra dhe kërkonte rikthimin e tij në punë. Po sipas kërkuesit, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, i paqartë dhe jo i plotë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos u dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të tij, ndonëse shkaqet e ngritura në të ishin të argumentuara dhe të mbështetura ligjërisht. Po kështu, ai nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për shkeljet kushtetuese të gjykatës së apelit, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, e duke mos dhënë arsytet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore.

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadinë me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror në formën e dëmit shëndetësor, integritetit fizik, si dhe cenimit të nderit, personalitetit dhe reputacionit nga veprimet e paligjshme të palës së paditur në shumën 12.571.911 lekë. Lidhur me këto kërkime, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se në bazë të vendimit unifikues nr. 31/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe të analizës së bërë në vendim lidhur me përgjegjësinë kontraktore dhe atë jokontraktore, ka vlerësuar se kërkimi i kërkuesit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga urdhri nr. 184, datë

16.06.2016 i Prokurorit të Përgjithshëm ishte një dëm që rridhte nga marrëdhënia e tij e punës dhe jo dëm jashtëkontraktor i shkaktuar nga organi i administratës publike. Duke qenë i tillë, pavarësisht se është pretenduar si dëm moral, ky dëm i është dëmshpërblyer kërkuetit sipas vendimit nr. 70, datë 02.02.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 4627, datë 10.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*shih faqen 9 të vendimit nr. 137 (80-2022-145), datë 26.01.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

29. Pas shqyrtimit të ankimit të kërkuetit, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ajo e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe është shprehur me vendim për të gjitha kërkimet në padi në respektim të parimit të disponibilitetit. Sipas gjykatës së apelit, konflikti mes palëve ndërgjyqëse buron nga kontrata e punës që ka ekzistuar ndërmjet kërkuetit dhe palës së paditur dhe në këtë rast, ndryshe nga sa pretendohet nga ai, nuk ka dëm jashtëkontraktor dhe përgjegjësi jashtëkontraktore të organeve të administratës publike, për sa kohë që kërkueti pretendon se ky dëm i ka ardhur nga ish-punëdhënësi i tij për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës. Po kështu, gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkitimi i kërkuetit për shpërblimin e dëmit të plotë të shkaktuar (si dëmit pasuror, ashtu edhe dëmit jopasuror) nga urdhri i paligjshëm i punëdhënësit është trajtuar dhe zgjidhur me vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit. Me anë të këtij të fundit, është vendosur jo vetëm konstatimi i pavlefshmërisë absolute të urdhrimit të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe detyrimi i palës së paditur t'i paguajë paditësit 12 paga mujore në formën e dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së paligjshme të kontratës së punës. Në të tilla rrethana, gjykata e apelit ka vlerësuar se pas këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë, kërkueti nuk mund të pretendojë dhe të kërkojë përsëri gjyqësisht nga ish-punëdhënësi i tij shpërblim dëmi kontraktor të shkaktuar nga zgjidhja e kësaj kontrate pune, që do të thotë se në rastin konkret kemi gjë të gjykuar, ndaj, me të drejtë, padia e paditësit është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë (*shih faqet 15 dhe 16 të vendimit nr. 535 (86-2023-781), datë 17.07.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

30. Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ i saj ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit, me arsyetimin se rekursi i kërkuetit nuk plotësonte kushtet paraprake të pranueshmërisë sipas nenit 480 (a) të KPC-së, pasi shkaqet e rekursit haptazi nuk mbështeteshin në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ky kolegji ka vënë në dukje se pasi është njohur me aktet e çështjes ka konstatuar se në përmbajtje të rekursit nuk përcaktohet asnjë prej rasteve të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, që bën të mundur pretendimin për cenimin në thelb

të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas tij, është detyrë e palës rekursuese të parashtrijë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe se përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit (*shih paragrafët 11 dhe 12 të vendimit nr. 00-2024-297, datë 05.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

31. Në analizë të vendimeve objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në kërkesëpadi janë rrëzuar si të pabazuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pasi ato kanë vlerësuar se shpërblimi i dëmit të plotë pasuror dhe jopasuror i shkaktuar ndaj tij, përmes aktit administrativ të punëdhënësit, është trajtuar dhe zgjidhur me vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, përmes të cilit është vendosur jo vetëm konstatimi i pavlefshmërisë absolute të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe detyrimi i palës së paditur t'i paguajë kërkuesit 12 paga mujore në formën e dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së paligjshme të kontratës së punës.

32. Në analizë të vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se ai nuk rezulton të jetë i paqartë, nuk përmban kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë, ndërkohë që pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Në vendim pasqyrohen në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, vendimmarrjet e gjykatave të faktit, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e Kolegjit Administrativ për natyrën e këtyre shkaqeve, në këndvështrim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Arsyetimi i kufizuar i këtij vendimi nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor për këtë kategori vendimesh, përmes të cilëve vendoset mospranimi i rekursit. Ndonëse me arsyetim të kufizuar, ashtu siç është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese, në vendim Gjykata e Lartë i ka trajtuar në mënyrë të përmbledhur pretendimet kërkuesit, duke mos gjetur shkelje nga gjykatat e zakonshme.

33. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit janë haptazi të pabazuara.

34. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.